

Roli i Grave dhe Burrave në Shoqëri

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Barazia, Respekti, Qytetaria, Solidariteti.

Qëllimet

Pedagogjike: Reflektimi rreth barazisë gjinore, rëndësisë së saj dhe ndikimit në jetën e gjithsecilit dhe në shoqëri në përgjithësi.

Praktike: Realizimi i një reflektimi individual dhe në grup rreth mënyrës se si djemtë dhe vajzat trajtohen në familje dhe në komunitet.

Pjesëmarrësit

Minimumi: 3 pjesëmarrës
Maksimumi: 30 pjesëmarrës

Kohëzgjatja

90 deri 120 minuta

Materialet


Letër dhe laps

Përmbledhje

Mësuesi/ja duhet të ftojë nxënësit që të reflektojnë mbi mënyrën se si trajtohen djemtë dhe vajzat në shoqëri përmes një rrëfimi autobiografik. Sugjerohet që mësuesi tu bëjë nxënësve pyetjet e mëposhtme duke i lënë 15 minuta të reflektojnë individualisht:

- Kush ndihmon zakonisht në punët e shëpisë?
- Kush u shërben zakonisht të ftuarve në shtëpi?
- Kur diçka u shpërndahet fëmijëve, kujt i jepet prioritet për të zgjedhur ose për të marrë i pari?
- A ka ndonjë privilegj në lidhje me mundësinë e investimit më të shtrenjtë në edukim midis djemve dhe vajzave?
- Si trajtohen vajzat dhe djemtë në familjen tënde? Po në komunitet? Ka ndryshime të mëdha në trajtimin e tyre?
- Si ndiheni rreth këtij trajtimi? Pse duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë djemtë dhe vajzat?
- Cilat janë sjelljet/qëndrimet e tua përsa i përket mënyrës se si duhet të trajtohen djemtë dhe vajzat?

Pas reflektimit individual, mësuesi/ja duhet t'i organizojë nxënësit në grupe me 4-5 veta, që të ndajnë reflektimet e tyre. Grupi duhet të caktojë një person që do të prezantojë përfundimet e grupit për klasën. Mësuesi mund të shënojë përfundimet kryesore në tabelë.



Roli i Grave dhe Burrave në Shoqëri

Fleta e Mësuesit (vazhdimi)

Diskutimi

Pas prezantimit të perfundimeve të të gjithë grupeve, rekomandohet një analizë e përgjithshme e aktivitetit dhe një debat rreth barazisë gjinore.

Cilat janë përfundimet kryesore që mund të nxjerrim nga zhvillimi i këtij aktiviteti?

Çfarë do të zhvillonit ju për të nxitur barazinë gjinore?

Keni ndjerë ose keni qenë dëshimtarë të ndonjë situate të diskriminimit gjinor në familjen ose komunitetin tuaj? Nëse po, si jeni ndjerë? Çfarë bëtë? Nëse do të ndodhte sot, çfarë do të bëje ndryshe?

Mendoni se vendi juaj po bën një punë të mirë në fushën e barazisë gjinore? Pse?

